



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 60, datë 02.12.2022

PËR  
VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATËVE ARTA VORPSI DHE GENT  
IBRAHIMI QË KONKUROJNË NË VENDIN VAKANT TË SHPALLUR NGA  
KUVENDI I SHQIPËRISË ME DATË 16.01.2022

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të neneve 229, 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

V E N D O S I :

1. Për efekt të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës Arta Vorpsi, që konkuron për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë me datë 16.01.2022, administrohet Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 47, datë 28.10.2022 “Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës së Arta Vorpsi në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.”
2. Për efekt të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit Gent Ibrahim, që konkuron për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë me datë 16.01.2022, administrohet Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 46, datë 28.10.2022 “Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës së Gent Ibrahim në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.”
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

SOKOL BINAJ

